

Skenderbeu/ Ne Korce duan te gjithe denimin e Kukesit

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 09 Dhjetor 2013 23:22



Skenat e dhunes, goditjet ndaj Joses dhe Muzakes por dhe dhuna psikologjike ndaj te tjereve duhet denuar. Ne Korce te gjithe presin nje denim maksimal per rivalet e Kukesit te cilet nuk e pranuan qetesisht verdiktin e fushes. Pritet qe Komisioni i Disiplines ne Federaten Shqiptare te Futbollit te marre ne analize keto skena te shemtuar dhe te marre me pas masat e duhura. Skenderbeu ben apel per te mos e kaluar qetesisht dhe pa masa ate qe ndodhi ne stadiumin e Kukesit ne ndeshjen qe u luajt te shtunen.